

AKADEMIK Kristaq PRIFTI

NGA LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT TE PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE E KOSOVËS

Këto tri ngjarje të historisë sonë kombëtare, edhe pse të largëta në kohë nga njëra-tjetra, janë të lidhura organikisht ndërmjet tyre, kanë një përmbajtje dhe objektiv thuajse të përbashkët, janë tri hallka të të njëjtit proces të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare që ka dominuar historinë bashkëkohore të shqiptarëve në këta 130 vjetët e fundit.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit shënoi një epokë të re në historinë e popullit shqiptar, përbën përpjekjen e parë që shqiptarët ndërmorën në periudhën e Rilindjes, në përmasa mbarëshqiptare dhe në rrafshin ndërkombëtar, për të zgjidhur çështjen kombëtare duke bashkuar territoret e tyre në një shtet të vetëm, qysh në vitet e Krizës Lindore të 1875-1881-it dhe thuajse në një kohë me popujt e tjerë të Ballkanit, në kuadrin e ndryshimeve që Shtetet e Mëdha bënë atëherë në hartën politike të këtij Gadishulli.

Duke vlerësuar konceptin e Lidhjes për krijimin e një shteti shtet të vetëm kombëtar, i cili në periudhën e parë do të kishte formën e një shteti autonom, me të gjitha atributet e tij, si një koncept themelor, të drejtë e realist, po sjellim në këtë kumtesë disa të dhëna për vendin që ka zënë në mendimin politik të Lidhjes ideja

e pavarësisë së Shqipërisë, e cila ka qenë gjithashtu e pranishme në gjirin e lëvizjes kombëtare të periudhës së Lidhjes së Prizrenit. Përfaqësuesit e Komitetit të Stambollit, të grumbulluar rreth Abdyl Frashërit qysh në korrik të 1877, pa përfunduar ende lufta rusoturke e 1877-78, përpunuan idenë e formimit të një shteti të pavarur kombëtar shqiptar dhe në fund të 1877 u orvatën të organizojnë në Shqipëri kryengritjen e përgjithshme të armatosur, e cila do të çonte në formimin e një qeverie të përkohshme shqiptare dhe në shpalljen e pavarësisë së vendit.¹ Në mënyrë edhe më të përcaktuar e të plotë ideja e pavarësisë së Shqipërisë u parashtrua në memorandumun e patriotëve shkodranë (të nënshkruar nga 500 vetë), dërguar kryeministrit dhe kryetarit të delegacionit anglez në Kongresin e Berlinit lordit Bikonsfild (Beaconsfield) më 13 qershor 1878, ku në emër të kombit shqiptar kërkohej nga Fuqitë e Mëdha respektimi i tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe njohja e pavarësisë së saj të plotë.²

Edhe pse për shkak të rrethanave të ndërlikuara ndërkombëtare, në të cilat u gjend Shqipëria pas disfatës së Perandorisë Osmane në luftën ruso-turke të viteve 1877-1878, pas Traktatit të Shën Stefanit (5 mars 1878) dhe vendimeve të Kongresit të Berlinit (10 qershor-10 korrik 1878), udhëheqësit e Lidhjes nuk e shtruan haptazi e drejtpërdrejtë kërkesën e pavarësisë dhe u kufizuan me atë të autonomisë, ata vijuan ta konsideronin atë si pjesë të pandarë të mendimit politik të Lidhjes, si objektiv të fundit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Për udhëheqësit e Lidhjes ishte i papranueshëm mendimi që Shqipëria të mbetej përjetësisht nën Perandorinë Osmane. Ata nuk e konceptonin autonominë e Shqipërisë si një zgjidhje përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare, por si një zgjidhje të përkohshme, si një shkallëz, si një hallkë transitore drejt pavarësisë.

¹ *Historia e popullit shqiptar, vëll. II*, Tiranë, 2002, f. 140-141, 143-145.

² *Akte të Rindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, përgatitur nga S. Pollo-S. Pula, Tiranë, 1978, dok.11,13 qershor 1878, f..21-29.

Si politikanë të aftë, që e njihnin përvojën e lëvizjeve kombëtare në Ballkan, udhëheqësit e Lidhjes së Prizrenit i referoheshin në këtë rast shembullit të vendeve të Ballkanit (të Serbisë, Greqisë, Rumanisë, Bullgarisë etj.), që kaluan drejt pavarësisë nëpërmjet një organizimi autonom shtetëror. Këtë kuptim i jepte Abdyl Frashëri konceptit të autonomisë, kur në artikullin "Lidhja Shqiptare", botuar në "Mesazhe të Vienës" ("Mesager de Vienne"), më 24 tetor 1878, e krahasonte statusin që do të kishte shteti autonom shqiptar me atë që Kongresi i Berlinit i pat dhënë Bullgarisë më 1878,³ kur e njohu si një principatë thuajse të pavarur.

Këto synime të pashpallura zyrtarisht të Lidhjes për pavarësinë e Shqipërisë dhe për shkëputjen e saj nga Perandoria osmane nuk ishin të panjohura edhe për administratën osmane dhe Portën e Lartë. Konsulli i përgjithshëm i Perandorisë Osmane në Raguzë, duke i përcjell Portës së Lartë, në dhjetor të vitit 1878, një përmbledhje të programit të Lidhjes së Prizrenit, theksonte, përveç të tjerave se "themeluesit e udhëheqësit e saj kanë pranuar si synim të vetin të ndërpresin me vendosmëri dhe qysh më parë të gjitha lidhjet me osmanët e tjerë...". Shefat e Lidhjes, siç i quante autori i këtij relacioni udhëheqësit e saj, po punojnë që duke shfaqur besnikërinë ndaj perandorisë, të sigurojnë edhe konstitucionin e ardhshëm të Shqipërisë në një mënyrë të tillë që në një të ardhme sa më të afërt ta bëjnë atë një Principatë suzerene (autonome, nën suzerenitetin e sulltanit) e më pas sovrane (të pavarur). Por duke njohur këtë aspiratë të krerëve të Lidhjes për një Principatë të pavarur, funksionarët osmanë theksonin gjithashtu se "promoterët e këtyre ideve janë aq mendjehollë sa të mos kërkojnë ipso facto (detyrimisht) Principatën, prandaj kufizohen me kërkesën për ta shpallur Shqipërinë një province të vetme, të bashkuar me një autonomi të gjerë."⁴

3 "Le Messager de Vienne", Vienne, 24 tetor 1878.

4 Başbakanlık Osmanlı Arşivi İstanbul. (më tej:BOAI). Fondi: HR. SYS Dosja 115/42, Fl.1/3.Relacion i konsullit të përgjithshëm të Turqisë në Raguzë, Danish Efendiut, Raguzë, 20 dhjetor 1878, Dërguar Karateodor Pashës, Ministër i Punëve

Këtë ide të pavarësisë funksionarët osmanë ia atribuonin edhe lidhjeve të ngushta të mjaft bejlerëve shqiptarë me komitetet revolucionare të vendeve të perëndimit. Ndonëse (bejlerët shqiptarë-shën. aut.) nuk i kuptonin shumë nga idetë e tyre ultrademokratike, thuhej në një aktet e administratës osmane, ata dëgjojnë këshillat e tyre dhe kanë pranuar fjalën plot prestigj: "Pavarësi" (Independencë).⁵

Edhe Porta e Lartë, duke vënë theksin në këtë synim të Lidhjes, shpallte në vendimin e saj të 1 janarit të vitit 1879 se Lidhja e Shkodrës, e Kosovës dhe e Dibrës me Toskerinë kërkonin ta vinin "Shqipërinë nën një administrim të ri e të pavarur".⁶ Ishte ky shqetësimi i Stambollit për mundësinë e shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane ai faktor, që krahas qëndrimit refraktar të disa prej Fuqive të Mëdha, i nxiti Portën e Lartë dhe sulltanin të prapësonin në qershor të vitit 1880 vendimin që kishin marrë për formimin e vilajetit të bashkuar të Rumelisë (faktikisht të Shqipërisë), në të cilin do të përshiheshin vilajetet shqiptare të Kosovës, të Manastirit, të Shkodrës e të Janinës. Porta e Lartë dhe sulltani e anuluan këtë vendim, ngaqë, siç shpreheshin ata vetë, ishin të bindur se Lidhja kishte si qëllim të fundit "ta vinte Shqipërinë nën një administrim të pavarur".⁷

Shpallja nga K. Q. i Lidhjes në janar të vitit 1881 e Qeverisë së Përkohshme, të kryesuar nga kryetari i saj, personaliteti i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Ymer Prizreni, dëshmonte gjithashtu për orientimin e Lidhjes e të udhëheqësve të saj, Ymer Prizrenit, Abdyl Frashërit, Sulejman Vokshit etj. drejt shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe shndërrimit të saj në një shtet të pavarur, me qeverinë e vet kombëtare. Sikurse pohoi Abdyl Frashëri në fjalën e mbajtur në mbledhjen e Komitetit Qendror të Lidhjes, të janarit të

të Jashtme në Konstantinopojë.

5 Po aty.

6 *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878-1881*, Përgatitur nga K. Prifti, Tiranë, 1978, dok8, f.25-28. Shih edhe: HHStA,PA,A. Byjkdere, 29 qershor, 1880, nr.52.

7 Po aty, dok.45, 47, 48.

vitit 1881, ku u vendos themelimi i Qeverisë së Përkohshme, krerët e saj e ndërmorën këtë veprim "pasi u bindën përfundimisht se Porta e Lartë nuk donte të bënte asgjë për Shqipërinë...Në këto rrethana, theksoi ai,- të mendojmë e të punojmë për vete dhe të gjithë, pa dallim, toskë e gegë të veprojmë si shqiptarë, të krijojmë një Shqipëri të bashkuar".⁸

Këtë kuptim i jepte formimit të Qeverisë së Përkohshme, ose Guvernës së Përdorme, siç e quante ai, edhe Sami Frashëri, kur në letrën që i dërgonte de Radës, më 20 shkurt të vitit 1881, shkruante se me këtë masë "...Lidhja e Prizrenit e pa të nevojshme të bashkojë Shqipërinë e ta bëjë një dhe me autonomi, e mbase me shkëputje (independencë) fare".⁹

Si një institucion shtetëror shqiptar, të pavarur nga Stambolli e trajtonte Qeverinë e Përkohshme edhe Dervish Pasha, kur në thirrjen, drejtuar shqiptarëve në prill të vitit 1881, gjatë ekspeditës ushtarake për shtypjen e Lidhjes, deklaroi se "në një vend nuk mund të ketë dy qeveri",¹⁰ domethënë dy shtete.

Lidhja e Prizrenit pati gjithashtu meritën që i dha lëvizjes kombëtare të periudhës së Rilindjes dhe jo vetëm asaj, por edhe të periudhës bashkëkohore, një koncept të plotë të territorit të shtetit shqiptar, pa të cilin nuk do të bëhej e mundur as ngritja e këtij shteti, as edhe ekzistenca e tij. Ndonëse mbronin me argumente të gjithanshme domosdoshmërinë e bashkimit të popullsisë e të territoreve shqiptare të të katër vilajeteve në një shtet të vetëm, udhëheqësit e Lidhjes e vinin theksin te gjuha shqipe, që ishte tipari i përbashkët dhe një nga më kryesorët e kombit. Në rezolutën e Kuvendit të Dibrës, të

8 M. Kodra, *Lidhja e Prizrenit, shikuar nga aspekti i disa dokumenteve britanike 1879-1881*, në: "Kosova" III, Prishtinë, 1974, f. 60-62. (Selanik, Blunt, 1 mars 1881 A.M.M. 25.FO.28/3316).

9 Sami Frashëri, Letër drejtuar De Radës, 20 shkurt 1881. Në: Sami Frashëri, *Vepra 2*, Tiranë, 1988, f.376.

10 HHStA,PA,A. Informacion i ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, 22 prill 1881.

8 nëntorit të vitit 1878, ku morën pjesë përfaqësues të Gegërisë e të Toskërisë, domethënë të të gjitha territoreve shqiptare, thuhej se në kufijtë e vilajetit të bashkuar autonom do të përfshihej "popullsia prej 2 000 000 njerëzish, që ndodhen në sanxhaqet e Shkodrës, Pazarit të Ri, Prizrenit, Shkupit, Manastirit, Dibrës, Gjirokastrës, Beratit, Prevezës dhe Janinës, të njohur me emrin Shqipëri, e cila flet e gjitha të njëjtën gjuhë, gjuhën shqipe dhe është në 2/3 myslimane dhe 1/3 krishtere".¹¹

Koncepti i Lidhjes dhe i rilindësve për Shqipërinë, si atdheu i përbashkët i shqiptarëve, i një popullsie që fliste të njëjtën gjuhë, ishte një koncept i drejtë, shkencor. Një koncept i tillë qëndronte gjithashtu në themel të krijimit të shteteve kombëtare në Evropë e në Ballkan. Përgjithësisht në mendimin politik dhe në praktikën e të gjitha vendeve të Evropës është pranuar se kufijtë e vërtetë natyrorë të shteteve janë ata që përcaktohen nga gjuha dhe simpatia e përbashkët.

Në aktet e Lidhjes dhe në ato të të gjithë epokës së Rilindjes, Shqipëria përmendej si një njësi territoriale dhe etnike e përcaktuar qartë, si atdheu i shqiptarëve, por në asnjë nga këto akte nuk zihej në gojë emërtimi "Shqipëri e Madhe", i cili është një trillesë qëllimkeqe e propagandës së qarqeve politike të shteteve fqinje, që u hodh në qarkullim në fundin e shek. XIX për t'ia kundërvënë synimeve të natyrshme e të ligjshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për formimin e një shteti të bashkuar shqiptar. Togfjalëshi "Shqipëri e Madhe", që po dëgjohet më shpesh edhe në ditët tona në qarqet diplomatike e në media e që, për fat të keq, artikullohet edhe nga personalitete zyrtare evropiane, që janë miq të shqiptarëve dhe jo vetëm nga këta, por edhe nga ato shqiptare, e ka zanafillën e tij jo te shqiptarët, por te qarqet politike të atyre shteteve ballkanikë që kanë sot në kufijtë e tyre territore e popullsi shqiptare. Ato, ashtu si pararendësit e tyre në kohën e Lidhjes së Prizrenit, e shohin me

11 *Akte të Rilindjes...*, dok.35, f. 71-72.

smirë e shqetësim të pa justifikuar procesin e emancipimit kombëtar të shqiptarëve në Ballkan, e në radhë të parë çlirimin e Kosovës nga robëria serbe, pavarësinë e saj si dhe prirjet e gjithë shqiptarëve për t'u afruar në mënyrë të gjithanshme si pjesëtarë të të njëjtit komb, për të hyrë në rrugën e përparimit e për t'u integruar, së bashku me popujt e tjerë të Ballkanit, në Evropën e Bashkuar.

Duke trajtuar në këtë kumtesë mendimin politik të Lidhjes së Prizrenit theksojmë gjithashtu se ajo dhe udhëheqësit e saj i dhanë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të viteve 1878-1881 dhe të periudhës së Rilindjes në tërësi një orientim proevropian, properëndimor. Shqiptarët, megjithëse kishin qenë gjatë një periudhe thuajse 500-vjeçare nën një perandori të Lindjes siç ishte ajo osmane, sikurse provuan edhe ngjarjet e kohës së Lidhjes së Prizrenit, nuk e humbën jo vetëm identitetin e tyre kombëtar, por as identitetin e tyre si popull evropian, mbetën gjithnjë të ndërgjegjshëm për përkatësinë e tyre në familjen e popujve evropianë. Ishte kjo ndjenjë e përbashkësisë me popujt evropianë, ajo që i shtyri shqiptarët, të udhëhequr nga Lidhja e Prizrenit, të shprehnin dëshirën e tyre për të hyrë në rrugën e përparimit dhe të qytetërimit evropian. Kjo aspiratë e Lidhjes nuk ishte e panjohur edhe për Portën e Lartë dhe administratën e saj. Në një nga dokumentet e kësaj administrate, të dhjetorit të vitit 1878, theksohej se Komiteti (Lidhja), me programin e vet "kishte për qëllim t'i tregonte diplomacisë (kuptohet shteteve evropiane) se shqiptarët e të gjitha besimeve janë evropianë, dhe se ata nuk do t'i nënshtrohen fatit të myslimanëve të provincave të tjera të Rumelisë".¹²

Edhe kërkesën e autonomisë së Shqipërisë dhe të shkëputjes së saj në të ardhmen nga Perandoria Osmane udhëheqësit e Lidhjes e vlerësonin si "një të drejtë të popullit shqiptar për të hyrë në gjirin e familjes së madhe evropiane, së cilës, theksonin ata, i përkiste nga raca dhe gjinia".¹³

12 BOAI, Fondi: HR. SYS Dosja 115/42, Fl.1/3. Relacion i përmendur, Raguzë, 20 dhjetor 1878.

13 *Akte të Rilindjes...*, dok.35, f. 19-20.

Ruajnë edhe sot vlerën e tyre dhe tingëllojnë sikur të ishin thënë në ditët tona fjalët që Lidhja u drejtoi nga Preveza shteteve evropiane, në peticionin e saj të 28 shkurtit 1879, në të cilin deklaroi se nëse Evropa do ta ndihmonte kombin shqiptar të shkëputej nga Perandoria Osmane, të formonte shtetin e vet, “ai do të bëhej në Lindje (në Evropën juglindore-shën. aut.), një bashkëpunëtor aktiv i kombeve që ecin në rrugën e qytetërimit”.¹⁴

Edhe në ditët më të ashpra të qëndresës së armatosur, kur ushtritë osmane të Dervish Pashës po shtypnin lëvizjen shqiptare, Lidhja, në një nga peticionet e saj të fundit, dërguar ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Stamboll, më 15 prill 1881, duke këmbëngulur në kërkesën e saj për bashkimin e katër vilajeteve, në një të vetëm, që të mbante emrin Shqipëri, theksonte se kjo e drejtë i takonte Shqipërisë si një vend evropian. Meqë Shqipëria ndodhej në Evropë, thuhej në këtë peticion të Lidhjes, ishte nevojshme që të hynte në të qytetërimi evropian, që ajo të merrte pjesë në çdo lloj përparimi dhe në këtë rast, të mbetej i paprekur Atdheu, emri shqiptar dhe kombësia shqiptare. Përfaqësuesit e huaj konsullorë dhe diplomatikë në Shqipëri e në Stamboll, shihnin në këtë peticion synimin e Lidhjes për të ngritur në Shqipëri një administratë autonome, që të ishte e aftë të përhapte të gjitha sistemet përparimtare dhe qytetëruese të kontinentit evropian, në të cilin bënte pjesë. Kështu, theksonin këta, Lidhja mbronte edhe nderin kombëtar të popullit shqiptar.¹⁵

Ndonëse, për një varg arsyesh të brendshme e më tepër të karakterit ndërkombëtar, nuk arriti atëherë të përmbushte objektivat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të përcaktuara prej saj, ato ruajtën vlerën e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj lëvizjeje. Lidhja e Prizrenit ushtroi një ndikim të fuqishëm në ecurinë e kësaj lëvizjeje dhe në të ardhmen e kombit shqiptar.

14 Po aty, dok.40, f.76-78.

15 HHStA,PA, A. Relacion i ambasadorit austrohungarez në Konstantinopojë, 3.05.1881, nr. 32. Po aty. Përkthimi i peticionit të 15 prillit 1881 të Lidhjes, nr.32/1.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe themelimi i shtetit kombëtar shqiptar në Kuvendin e Vlorës, më 28 Nëntor 1912 i kanë rrënjët e tyre te Lidhja e Prizrenit, ishin vijim i drejtpërdrejt i veprës së nisur prej saj. Ashtu si Lidhja e Prizrenit edhe Kuvendi i Vlorës e Qeveria e Përkohshme, e kryesuar nga Ismail Qemali, që doli prej tij, morën përsipër misionin historik të zgjidhjes së plotë të çështjes kombëtare shqiptare duke formuar një shtet të bashkuar shqiptar. Pavarësia dhe formimi i shtetit shqiptar nuk u shpallën nga Kuvendi i Vlorës as në emër të atij territori të ngushtë shqiptar që kishte mbetur ende i lirë e i papushtuar nga shtetet ballkanike më 1912 (që shtrihej në hapësirën Vlorë-Lushnjë-Berat-Gjirokastër), as edhe në emër të atij shteti të cinguar që do të njihte më vonë Konferenca e Londrës e vitit 1913, shtet të cilin e trashëgojmë ne sot, por në emër të të gjitha trevave e të popullsisë shqiptare, që përfshiheshin në të katër vilajetet e atëhershme shqiptare e që dërguan përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Vlorës. Në deklaratat që u bëri Fuqive të Mëdha, më 28 dhe 29 nëntor 1912, I.Qemali, jo pa qëllim e vuri theksin në këtë realitet, duke u kumtuar atyre se Shpallja e Pavarësisë dhe formimi i Qeverisë së përkohshme ishin vepër e Asamblesë Kombëtare, në të cilën morën pjesë të bashkuar përfaqësuesit e të gjitha viseve të Shqipërisë, duke përfshirë edhe ato të pushtuara nga ushtritë e vendeve të Ballkanit, pa dallim feje dhe krahine.¹⁶ Por përfaqësuesit e Fuqitë e Mëdha, të mbledhur në Konferencën e Londrës (1913), ndonëse e njohën Shtetin e Pavarur Shqiptar, nuk i njohën atij sovranitetin mbi të gjitha territoret dhe popullsinë shqiptare duke e penguar kështu të zgjidhte përfundimisht çështjen e bashkimit të popullit shqiptar në një shtet të vetëm. Me vendimin e 22 marsit 1913 për kufijtë Verior e Verilindor dhe me atë të 11 gushtit për kufijtë Jugor, Konferenca, pa marrë në konsideratë kontributin e shqiptarëve në likuidimin e sundimit të Perandorisë Osmane në Ballkan, sidomos

16 *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë, 1963, dok. 23, 32, 33, 35, 36, 37, f. 42-45.

me kryengritjet e viteve 1910-1912, dhe parimin e kombësisë që qëndronte në themel të formimit të shteteve të Evropës dhe, duke i zëvendësuar ato me të drejtën e "luftës dhe të pushtuesit", i cungoi rëndë territoret shqiptare, i shkëputi Shqipërisë, Shtetit të Pavarur Shqiptar gjysmën e trojeve dhe të popullsisë, Kosovën, viset veriore të vilajetit të Shkodrës, Dibrën, Ohrin, gjithë luginën e Pollogut e Shkupin në Lindje dhe Çamërinë në Jug, të cilat ua aneksoi Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

Ngjarjen e dytë madhore në këtë proces historik të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare, pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe themelimit të shtetit shqiptar më 1912 e përbën Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, fillimet e së cilës duhet t'i kërkojmë gjithashtu në programin dhe veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Por Pavarësisë së Kosovës i parapriu një histori e tërë. Gjatë një periudhe thuajse 100-vjeçare që ka kaluar nga koha e copëtimit të Shqipërisë, çështja kombëtare shqiptare e në mënyrë të veçantë çështja e Kosovës dhe e trevave të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, që përbënin shumicën e popullsisë dhe të trojeve shqiptare që mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar, vazhdoi të mbetet gjithnjë e gjallë dhe e pranishme për shkak të aspiratës dhe të qëndresës së pandërprerë të popullsisë së saj shqiptare për t'u çliruar nga zgjedha e huaj, për të siguruar të drejtën e vetëvendosjes dhe për t'u bashkuar me Shtetin e Pavarur Shqiptar.

Ishte kjo qëndresë e gjithanshme e popullsisë së Kosovës që shoqëroi historinë bashkëkohore të shqiptarëve gjatë një shekulli të tërë e që arriti kulmin e saj me veprimet e armatosura të UÇK-së gjatë luftës së pashpallur që Serbia i imponoi Kosovës në vitet 1998-1999 ajo që përgatiti truallin për pavarësinë e Kosovës. Por në përshpejtimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ndikoi fuqishëm faktori ndërkombëtar e pikërisht ndryshimi (pas 87 vjetësh) i qëndrimit të SHBA-së dhe të shteteve të Evropës ndaj çështjes shqiptare. Ky ndryshim u shpreh në fillim në ndërhyrjet e tyre diplomatike për t'i dhënë fund politikës së gjenocidit të pashembullt që Serbia shpërtheu në Kosovë në vitet 1998-1999 e më pas, në pranverën e vitit 1999,

me ndërhyrjen ushtarake të forcave të NATOS që e detyroi Serbinë të tërhiqte, më 12 qershor forcat e saj ushtarake nga Kosova, dhe solli çlirimin e saj nga zgjedha serbe. Me këto ngjarje iu hap rruga zhvillimit të pavarur të Kosovës.

Rëndësi të veçantë pati në këtë proces unifikimi i qëndrimit të Bashkimi Evropian dhe ShBA për zgjidhjen e problemit të Kosovës, nëpërmjet një plani të përbashkët, planit të Ahtisaarit, i cili i njohu Kosovës atributet e një shteti të pavarur, me të gjitha garancitë për liritë demokratike dhe të drejtat e minoritetit serb etj.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës u sanksionua përfundimisht në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, që u mbajt më 17 shkurt 2008 në Prishtinë, në kryeqytetin e Kosovës, ku u miratua Deklarata e Pavarësisë. Më 8 prill 2008 Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Kosovës, që do të hyjë në fuqi, së bashku me paketën e Ahtisaarit më 15 qershor dhe përbën aktin më të lartë juridik të shtetit të pavarur, garancinë e ekzistencës së tij si shtet i pavarur, sovran e demokratik, që e njeh Kosovën si atdhe të të gjithë qytetarëve pa dallim etnie.

E vështruar nga pikëpamja e objektivit të përgjithshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk përbën ende një zgjidhje të plotë të çështjes kombëtare të shqiptarëve (për bashkimin e të gjitha viseve shqiptare në një shtet të vetëm), siç qe projektuar në programin e Lidhjes së Prizrenit. Por përvoja e lëvizjes kombëtare po tregon se në periudhën e sotme, për shkak të ndarjes gjeopolitike të kombit shqiptar në gjashtë njësi shtetërore, zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare në Ballkan, qoftë në aspektin e integritit kulturor dhe ekonomik të të gjithë hapësirës kombëtare, të të gjitha pjesëve të kombit, qoftë edhe në aspektin e bashkimit të tyre kombëtar në një shtet të vetëm, në kuptimin e plotë të fjalës, nuk mund të arrihet me një akt të vetëm e të menjëhershëm, por shkallë-shkallë, me një mënyrë graduale e afatgjatë ose, nëpërmjet të atij procesi që akademik Gazmend Zajmi e ka quajtur në studimet e

tij "policentrizmi subjektor i kombit shqiptar".¹⁷ Ky policentrizëm subjektor i kombit shqiptar në Ballkan, shëmbëllen e të cilit e dha formimi i shtetit të pavarur të Kosovës, krahas Republikës së Shqipërisë, nuk duhet parë si një faktor i ndarjes së kombit shqiptar, përkundrazi në kushtet e sotme të ndarjeve gjeopolitike të kombit tonë ai përbën një faktor të ngritjes së mëtejshme të subjektivitetit kombëtar shtetëror shqiptar, një kusht për integrimin brenda vetes të të gjithë kombit në tërësi, një kusht për procesin e bashkimit kombëtar. Në këtë raport duhet vendosur edhe Shpallja e Pavarësisë së Kosovës me çështjen e përgjithshme të bashkimit kombëtar të shqiptarëve.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës përbën, pa asnjë mëdyshje, një hap të mëtejshëm e vendimtar në zgjidhjen e problemit kombëtar shqiptar, sepse solli shkëputjen përfundimtare, zyrtare, formale nga Serbia, të njohur ndërkombëtarisht të popullsisë më të madhe shqiptare të ish-Jugosllavisë, të rreth 2 milionë shqiptarëve të Kosovës, vendosjen e sovranitetit të tyre të plotë mbi territoret e veta amtare, formimin, krahas Republikës së Shqipërisë, edhe të një shteti të dytë, etnikisht të njëjtë shqiptar, të Republikës së Kosovës. Ky do të jetë një akt me rrjedhoja vendimtare për të ardhmen e popullit shqiptar dhe të problemit të tij kombëtar në Ballkan.

Përmbledhje

Lidhja Shqiptare e Prizrenit përbën përpjekjen e parë që shqiptarët ndërmorën në periudhën e Rilindjes, në përmasa mbarëshqiptare dhe në rrafshin ndërkombëtar, për të zgjidhur çështjen kombëtare duke bashkuar territoret e tyre në një shtet të vetëm, qysh në vitet e Krizës Lindore të 1875-1881-it dhe thujse në

¹⁷ G.Zajmi, *Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë madhore e kohës dhe ndaj kohës, në: Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual*, Tiranë, 1996, f. 247.

një kohë me popujt e tjerë të Ballkanit, në kuadrin e ndryshimeve që Shtetet e Mëdha bënë atëherë në hartën politike të këtij Gadishulli.

Edhe pse për shkak të rrethanave të ndërlikuara ndërkombëtare, në të cilat u gjend Shqipëria pas disfatës së Perandorisë Osmane në luftën ruso-turke të viteve 1877-1878, pas Traktatit të Shën Stefanit (5 mars 1878) dhe vendimeve të Kongresit të Berlinit (10 qershor-10 korrik 1878), udhëheqësit e Lidhjes nuk e shtruan haptazi e drejtpërdrejtë kërkesën e pavarësisë së Shqipërisë dhe u kufizuan me atë të autonomisë, ata vijuan ta konsideronin pavarësinë si pjesë të pandarë të mendimit politik të Lidhjes, si objektiv të fundit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Dokumentacioni osman e në radhë të parë aktet e administratës osmane të cituara nga autori në këtë kumtesë, provojnë se këto synime të Lidhjes nuk ishin të panjohura edhe Portën e Lartë. Shpallja nga K. Q. i Lidhjes, në janar të vitit 1881, e Qeverisë së Përkohshme, të kryesuar nga kryetari i saj, personaliteti i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Ymer Prizreni dëshmoi gjithashtu për orientimin e Lidhjes e të udhëheqësve të saj drejt shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe për shndërrimin e saj në një shtet të pavarur, me qeverinë e vet kombëtare.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit i dha Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të viteve 1878-1881 dhe të periudhës së Rilindjes në tërësi një orientim proevropian, properëndimor. Shqiptarët, megjithëse kishin qenë gjatë një periudhe thuajse 500-vjeçare nën një perandori të Lindjes siç ishte ajo osmane, sikurse provuan edhe ngjarjet e kohës së Lidhjes së Prizrenit, nuk e humbën jo vetëm identitetin e tyre kombëtar, por as identitetin e tyre si popull evropian, mbetën gjithnjë të ndërgjegjshëm për përkatësinë e tyre në familjen e popujve evropianë.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe themelimi i shtetit kombëtar shqiptar në Kuvendin e Vlorës, më 28 Nëntor 1912 i kanë gjithashtu rrënjët e tyre te Lidhja e Prizrenit, ishin vijim i drejtpërdrejt i veprës së nisur prej saj. Ashtu si Lidhja e Prizrenit edhe Kuvendi i Vlorës e Qeveria e Përkohshme, e kryesuar nga Ismail Qemali, që

doli prej tij, morën përsipër misionin historik të zgjidhjes së plotë të çështjes kombëtare shqiptare duke formuar një shtet të bashkuar shqiptar. Por përfaqësuesit e Fuqitë e Mëdha, të mbledhur në Konferencën e Londrës (1913), ndonëse e njohën Shtetin e Pavarur Shqiptar, nuk i njohën atij sovranitetin mbi të gjitha territoret dhe popullsinë shqiptare duke e penguar kështu të zgjidhte përfundimisht çështjen e bashkimit të popullit shqiptar në një shtet të vetëm.

Ngjarjen e dytë në këtë proces historik të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare e përbën Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, që u sanksionua përfundimisht në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, që u mbajt më 17 shkurt 2008 në Prishtinë, në kryeqytetin e Kosovës, ku u miratua Deklarata e Pavarësisë. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës (rrënjët e së cilës duhet t'i kërkojmë gjithashtu në veprimtarinë dhe programin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), përbën, një hap të mëtejshëm e vendimtar në zgjidhjen e problemit kombëtar shqiptar, sepse solli shkëputjen përfundimtare, zyrtare, formale nga Serbia, të njohur ndërkombëtarisht, të popullsisë më të madhe shqiptare të ish-Jugosllavisë, të rreth 2 milionë shqiptarëve të Kosovës, vendosjen e sovranitetit të tyre të plotë mbi territoret e veta amtare, formimin, krahas Republikës së Shqipërisë, edhe të një shteti të dytë, etnikisht të njëjtë shqiptar, të Republikës së Kosovës. Ky do të jetë një akt me rrjedhoja vendimtare për të ardhmen e popullit shqiptar dhe të problemit të tij kombëtar në Ballkan.

AKADMIK Kristaq PRIFTI

SUMMARY

**FROM THE ALBANIAN LEAGUE OF PRIZREN TO THE
INDEPENDENCE OF ALBANIA AND KOSOVA**

The Albanian League of Prizren represents the first Albanian effort in the period of the Renaissance on pan-national and international level for resolution of national question through uniting ethnic territories in a unitary state. Despite difficult international circumstances on which Albania happened to be after the defeat of the Ottoman Empire in Russian-Turkish War 1877-1878, after the decisions of the Treaty of Saint Stephen (March 5, 1878) and the Congress of Berlin (June 10 – July 10, 1878), Albanian leaders of the League did not present an open demand for the Independence of Albania, restraining on demand for autonomy, despite continual consideration of the Independence as integral part of the League's political thinking. The establishment of the Provisional Government in January 1881 by the Central Committee of the League, headed from Ymer Prizreni also confirms Movements orientation for Albania's secession from the Ottoman Empire.

The Albanian League of Prizren gave to Albanian National Movement the European and Western orientation during 1878-1881, and also to the national Renaissance in general. The Declaration of Independence of Albania and formation of the national state in Assembly of Vlora on 28 November 1912, also is rooted on the Albanian League of Prizren. Similarly, the Albanian League of Prizren and the Assembly of Vlora and Provisional Government headed from Ismail Qemali took over the historical mission of resolving the

entire national question by forming a unified Albanian state. But, the representatives of the Great Powers assembled in the Conference of London (1913), in spite of recognition of the Independent Albanian State, did not recognize it as sovereign on all territories inhabited by Albanian population, thus hindering conclusive union of Albanian people into a single united state.

A second development of this historical process for resolution of Albanian national issue represents the Declaration of Independence of Kosova that finally concluded with the Assembly of Kosova Convention on February 17, 2008 in Prishtina, capital-city of Kosova, when was adopted the Declaration of Independence. Kosova's Independence Declaration (also, rooted into activity and program of the Albanian League of Prizren) represents a further decisive step in resolving Albanian national problem. This act, hand in hand with the Republic of Albania marks a second ethnic Albanian state alike, the Republic of Kosova. This will be decisive act for the future of Albanian nation in Balkans.